



Këto lule të bardha e të bukura që po i shihni nuk janë sikurse lulet tjera, ato janë të veçanta, janë lule acari. Ato formohen nga akulli, në temperatura shumë të ulëta, zakonisht në temperaturë  $-22^{\circ}\text{C}$ .

Këtë fenomen të çuditshëm e zbuluan, vitin e kaluar, profesori Jody Deming bashkë me studentin e tij Jeff Bowman, të cilët i kishte dërguar Universiteti i Uashingtonit në një studim të kombinuar për oqeanografi, mikrobiologji dhe shkenca planetare në Oqeanin Arktik qendror./Shembulli/